

SPAK *monitor*

PËRMBAJTJA

- Çështje të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
- Kohëzgjatja e çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
- Çështje të korrupsionit
- Çështje të krimit të organizuar
- Çështjet penale në fushën e korrupsionit të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
- Veprat penale
- Masat e dënimit: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë
- Çështjet penale në fushën e krimit të organizuar të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
- Çështje të tjera penale të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Spak Monitor Nr. 12 trajton ecurinë e çështjeve në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar të regjistruara në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke kryer një vlerësim përkundrejt disa indikatorëve të rëndësishëm në procesin e shqyrtimit gjyqësor të çështjeve.

Nëpërmjet kësaj analize dhe paraqitjes të aspekteve kryesore që lidhen me shqyrtimin gjyqësor të këtyre çështjeve, synohet të evidentohet niveli i efektivitetit dhe përgjigjes në trajtimin e çështjeve të

korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Ky botim vjen si një vazhdim i monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm që Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes ka kryer në kuadër të projektit: “Mbështetja e zbatimit të reformës në drejtësi nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit të SPAK dhe Gjykatave të Posaçme”, i mbështetur nga Programi i Reformës në Drejtësi, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.




Çështje të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar * (Prill-Qershor 2021)

Gjatë periudhës prill – qershor 2021 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë regjistruar në total 20 çështje të reja penale, 11 prej të cilave në fushën e korrupsionit, 6 në fushën e krimit të organizuar dhe 3 çështje të tjera të cilat përfshijnë vepra të tjera penale.

Muaji qershor 2021 rezulton të jetë muaji me numrin më të lartë të procedimeve penale të regjistruara me 9 të tilla, ndërkohë që në muajin maj 2021 në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë janë regjistruar 6 çështje penale dhe 5 çështje të tjera të regjistruara i përkasin muajit prill 2021.

Gjatë periudhës prill-qershor 2021 kjo gjykatë ka dhënë në total 19 vendime, 3 vendime për çështje penale të regjistruara gjatë periudhës prill-qershor 2021, 7 vendime për çështje penale të regjistruara gjatë periudhës janar-mars 2021 dhe 9 vendime, të cilat i përkasin çështjeve penale të mbartura nga viti 2020.

Në 10 vendimet e dhëna për çështje të vitit 2021, 7 prej tyre janë çështje në fushën e korrupsionit, 1 në fushën e krimit të organizuar dhe 2 prej tyre përfshijnë vepra të tjera penale. Në 9 vendimet për çështje të mbartura nga viti 2020, përfshihen 2 vendime për



Grafik 1: Numri dhe ecuria e gjykimit të çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

(1 Prill 2021 – 30 Qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

çështjeve në fushën e korrupsionit, 6 të krimit të organizuar dhe 1 prej tyre përfshin vepra të tjera penale. Deri në fund të muajit qershor 2021, nga 20 çështje në total të regjistruara gjatë periudhës prill-

qershor 2021, ka vazhduar gjykimi për 17 prej tyre, 9 prej të cilave në fushën e korrupsionit, 6 në fushën e krimit të organizuar dhe 2 prej tyre të lidhura me vepra të tjera penale.

Kohëzgjatja e gjykimit të çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar * (Prill-Qershor 2021)

Çështje të korrupsionit

Për të llogaritur kohëzgjatjen e çështjeve penale të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, janë përfshirë data e regjistrimit të çështjes në gjykatë dhe data e shpalljes së vendimit. Intervali kohor i përdorur për vlerësimin e çështjeve përfshin segmentet kohore: **më pak se 1 muaj, 1-6 muaj, 7-12 muaj, 1-2 vjet dhe më shumë se 2 vjet.**

Bazuar në parashikimet e Kodit të Procedurës Civile në Nenin 399/2/d, afati i arsyeshëm i gjykimit të krimeve në gjykimin penal në shkallë të parë është **deri në 2 vjet** ndërsa përfundimi i gjykimit për krimet në gjykimin në apel është **1 vit.**

Nga vlerësimi i realizuar për 19 çështjet penale për të cilat ka përfunduar gjykimi në këtë gjykatë gjatë periudhës kohore prill-qershor 2021, evidentohet që për 3 prej tyre gjykimi ka përfunduar për një periudhë kohore më **pak se 1 muaj** dhe për 6 të tjera gjykimi ka përfunduar brenda periudhës kohore prej **1-6 muajsh.**

Çështje të krimit të organizuar

Për 3 çështje në fushën e krimit të organizuar gjykimi ka zgjatur

Nr. dhe lloji i Çështjes	Kohëzgjatja e çështjes				
	< 1 muaj	1-6 muaj	7-12 muaj	1-2 vjet	> 2 vjet
Nr. 2 – Krim i organizuar (2017)					1269 ditë
Nr. 20 – Krim i organizuar (2019)				609 ditë	
Nr. 47 – Krim i organizuar (2020)			321 ditë		
Nr. 48 – Krim i organizuar (2020)			281 ditë		
Nr. 60 – Krim i organizuar (2020)			261 ditë		
Nr. 68 – Korrupsion (2020)		209 ditë			
Nr. 82 – Të tjera (2020)		170 ditë			
Nr. 90 – Korrupsion (2020)		181 ditë			
Nr. 10 – Krim i organizuar (2021)		86 ditë			
Nr. 18 – Korrupsion (2021)		78 ditë			
Nr. 21 – Korrupsion (2021)		128 ditë			
Nr. 23 – Korrupsion (2021)		42 ditë			
Nr. 26 – Korrupsion (2021)	23 ditë				
Nr. 27 – Të tjera (2021)	28 ditë				
Nr. 29 – Korrupsion (2021)	18 ditë				
Nr. 35 – Korrupsion (2021)		37 ditë			
Nr. 41 – Të tjera (2021)	16 ditë				
Nr. 46 – Korrupsion (2021)	16 ditë				

Tabela 1: Kohëzgjatja e gjykimit (në ditë) për çështjet penale për të cilat ka përfunduar gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

(1 Prill 2021 – 30 Qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

brenda intervalit prej **7-12 muaj**, për 1 çështje brenda intervalit **1-2 vjet** dhe për 1 çështje gjykimi ka tejkaluar afatin prej **2 vjetësh.** Vetëm 1 çështje për krim të organizuar e regjistruar në vitin

2021 është gjykuar për një periudhë kohore prej 86 ditësh.

Çështjet penale në fushën e korrupsionit të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar * (Prill-Qershor 2021)

Veprat penale


Çështjet penale në fushën e korrupsionit përbëjnë numrin më të lartë të çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë gjatë periudhës kohore prill-qershor 2021, prej **11 çështjesh** nga 20 në total.

Ashtu sikurse edhe për çështjet penale në fushën e korrupsionit të regjistruara në këtë gjykatë gjatë vitit 2020, dhe gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2021, dominojnë akuzat penale të korrupsionit ndaj **personave që ushtrojnë funksione publike**.

Specifikisht, veprat penale të korrupsionit aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike dhe korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike përbëjnë akuzat kryesore të këtyre çështjeve edhe për 3-mujorin të dytë të vitit 2021.

Sikurse gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2021, **asnjë çështje penale** në fushën e korrupsionit e regjistruar gjatë periudhës prill-qershor 2021 nuk përfshin akuza për korrupsion kundrejt funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë.

Gjatë vitit 2021 Parlamenti i Shqipërisë, miratoi ndryshimet në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë (Ligj 43/2021, hyrë në fuqi në datën 1 qershor 2021), të cilat ndodhën paralelisht me



Grafik 2: Numri i veprave penale në çështjet e korrupsionit të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

(1 Prill 2021 – 30 Qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale lidhur me kompetencat lëndore të Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Specifikisht, veprat penale të parashikuara në nenet 244, 245/1, 258, dhe 259 të Kodit Penal u

riformuluan duke vendosur **limite monetare** për cilësimin e këtyre veprave penale dhe për rrjedhojë, duke përshtatur masën e dënimit në varësi të rrethanave cilësuese përkatëse.

Masat e dënimit: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë

Gjatë periudhës prill-qershor 2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka dhënë në total 9 vendime për çështje në fushën e korrupsionit. Duke qene se gjatë kësaj periudhe nuk janë publikuar ende dispozitivët për 5 prej këtyre vendimeve, kjo analizë i referohet vetëm 4 vendimeve për të cilat është publikuar informacion i përmbledhur nga gjykata.

Në 2 nga këto vendime të dhëna Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, rezultojnë masa të dënimit me burgim, specifikisht prej 10 muajsh dhe 6 muajsh. Ndërkohë për 2 vendimet e tjera masat e ekzekutimit të dënimit me burgim janë zëvendësuar me periudhë vënie në provë. (Shiko Aneks A)

Edhe përgjatë vitit 2020 dhe 3-mujorit të parë të vitit 2021, në pjesën më të madhe të çështjeve të korrupsionit të regjistruara në këtë gjykatë, masat e ekzekutimit të dënimit me burgim janë zëvendësuar me periudhë vënie në provë.

Vendosja e kontakteve me shërbimet e provës dhe vënia në provë duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, mund të vendoset nga gjykata duke marrë në konsideratë disa kushte të caktuara.

Këto kushte përfshijnë rreziksh-




Figura 1: Masat e dënimit të dhëna nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për procedimet penale të korrupsionit në rastet e Pezullimit të vendimeve të dënimit (1 Prill 2021 – 30 Qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

mërinë e paktë të personit, moshën, kushtet shëndetësore apo mendore, mënyrën e jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanat e kryerjes së

veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së kësaj vepre. Ndërkohë detyrimet, të cilat i dënuari detyrohet të plotësojë nga gjykata parashikohen në nënin 60 të Kodit Penal.

Çështjet penale në fushën e krimit të organizuar të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar * (Prill-Qershor 2021)

Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë janë regjistruar gjatë periudhës prill-qershor 2021, **6 çështje penale** në fushën e krimit të organizuar, për asnjërën prej të cilave deri në datën 30 qershor 2021 nuk ka përfunduar gjykimi.

Veprat në **fushën e narkotikëve** dhe ato në **kuadër të organizatës kriminale** përbëjnë numrin kryesor të akuzave në çështjet penale në fushën e krimit të organizuar, ndërkohë që numri i të pandehurve në këto çështje rezulton të jetë i ulët.

Në 4 prej tyre numri i të pandehurve është 2 dhe në 1 çështje numri i të pandehurve është vetëm 1. Në vetëm 1 çështje të regjistruar gjatë kësaj periudhe numri i të pandehurve është më shumë se 12 persona të akuzuar.

Nga vlerësimi në tërësi i çështjeve në fushën e krimit të organizuar, **vrasja** dhe **vjedhja** konsiderohet të jenë mënyrat kryesore të veprimit (modus operandi) të krimit të organizuar për kryerjen e veprimtarisë kriminale, ndërkohë që **ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve** përbën një nga veprimtaritë kryesore kriminale, të ndërmarra për kryerjen e veprave penale në fushën e krimit të organizuar.

	3 – 5 persona të pandehur
	5 – 10 persona të pandehur
	> 10 persona të pandehur

Neni 28/4, Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jomateriale
Neni 333, Organizata kriminale
Neni 333/a, Grupi i strukturuar kriminal
Neni 333/a/1, Krijimi, organizimi ose drejtimi i një grupi të strukturuar kriminal për kryerjen e veprave penale
Neni 333/a/2, Pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal
Neni 334, Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal
Neni 334/1, Kryerja e veprave penale nga pjesëtarë të organizatës kriminale dhe të grupit të strukturuar kriminal

Nr. i çështjes	Numri i të pandehurve	Veprat penale në kuadër të organizatave kriminale
32.	12	Nenet: 333/a/2; 333/a; 333; 333/a/1 dhe 334
33.	2	/
36.	2	Neni 333/a/2
37.	2	Nenet: 333/a; 333/a/1; 334; 334/1
44.	2	Nenet: 333/a/2; 334/1
45.	1	Neni 333/a/1

Tabela 2: Numri i të pandehurve në çështjet penale në fushën e krimit të organizuar, ku përfshihen vepra penale në kuadër të organizatave kriminale

(1 Prill 2021 – 30 Qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Një nga mangësitë në vlerësimin e çështjeve në fushën e krimit të organizuar vazhdon të mbetet vlerësimi i dëmit ekonomik shkaktuar në ekonominë e ligjshme.


Çështje të tjera penale të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar * (Prill-Qershor 2021)

Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë janë regjistruar gjatë periudhës prill-qershor 2021 edhe 3 çështje të cilat lidhen me akuza të tjera penale kundrejt subjekteve të parashikuara në kompetencë të Prokurorisë dhe Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për 1 nga 3 çështjet e regjistruara, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka përfunduar gjykimin. E akuzuara në këtë çështje ka qenë ish-kryetarja e Bashkisë Gjirokastër me akuzën e shpërdorimit të detyrës. Gjykata e Posaçme ka dhënë masën e dënimit prej 8 muajsh burgim, e cila është zëvendësuar me 120 orë punë në interes publik.

Dy çështjet e tjera të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, për të cilat deri në fund të muajit qershor 2021 ka vazhduar gjykimi, përfshijnë akuza për shpifje ndaj Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

Për të njëjtat akuza, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka vendosur moskompetencën lëndore në lidhje me shqyrtimin e 5 çështjeve. Të 5 këto çështje përfshijnë akuzat për shpifje dhe



Grafik 3: Vepra të tjera penale të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

(1 Prill 2021 – 30 Qershor 2021)

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

fyerje ndaj Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ndërkohë që për 3 prej tyre Gjykata e Posaçme ka vendosur gritjen përpara Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë të mosmarrëveshjes për kompetencë

lëndore në shqyrtimin e çështjeve dhe për 1 prej tyre është vendosur dërgimi i akteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ANEKS A: Masat e dënimit të kërkuara nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe masat e dënimit të dhëna nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për procedimet penale për korrupsionin për të cilat ka përfunduar gjykimi në shkallën e parë (1 Prill 2021 – 30 Qershor 2021)

Nr. i çështjes	Veprat penale	Baza ligjore dhe masa e dënimit	Masa e dënimit e kërkuar nga Prokuroria	Masa e dënimit e dhënë nga Gjykata
23	Kërkimi, marrja ose pranimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për veten e tij ose për persona të tjerë, duke premtuar ose siguruar aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë funksione publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është kryer ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara publike, shqiptarë ose të huaj, pavarësisht nëse është realizuar ushtrimi i ndikimit ose kanë ardhur apo jo pasojat e dëshiruara	Neni 245/1/2 6 muaj – 4 vjet	Miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit.	Miratimin e marrëveshjes datë 21/02/2021 për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit prej 10 muajsh .
26	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit	Miratimin e marrëveshjes datë 17.03.2021 për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim prej 7 muajsh dhe vënia në provë për një periudhë prej 1 vit e 2 muaj .
29	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt	Neni 244 6 muaj-3 vjet Neni 291 10 ditë-3 vjet (Gjykata mund të vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit.)	5 muaj	6 muaj
35	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	Neni 244 6 muaj-3 vjet	Miratimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim prej 7 muajsh dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbush një punë në interes publik, prej 120 orë duke u kryer kjo punë brenda afatit prej 6 muajsh.	Miratimin e marrëveshjes datë 30.04.2021 për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit. Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim prej 7 muajsh dhe zëvendësimi i tij me detyrimin që i dënuari të përmbush një punë në interes publik, prej 120 orë duke u kthyer kjo punë brenda afatit prej 6 muajsh .

Burimi i të dhënave: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

¹ Në kohën që ka përfunduar përgatitja e SPAK Monitor Nr. 12 në ëeb faqen e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë nuk është publikuar Dispozitivi i Vendimit për çështje të korrupsionit nr.: 18, 21, 46, 68 dhe 90. Masat e dënimit për këto vendime nuk janë reflektuar në këtë analizë.

KY BULETIN REALIZOHET NË KUADËR TË PROJEKTIT: FORCIMI I INFORMIMIT DHE PJESMARRJES SË PUBLIKUT NË ZBATIMIN E REFORMËS NË DREJTËSI NËPËRMJET MONITORIMIT, VLERËSIMIT DHE KOMUNIKIMIT TË PROCESIT TË NGRITJES DHE FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Projekt i financuar nga:

Fondacioni

Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Gjatë periudhës Prill – Qershor 2021 Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) do të punojë për zbatimin e projektit të mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë “ Forcimi i informimit dhe pjesmarrjes së publikut në zbatimin e reformës në drejtësi nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe komunikimit të procesit të ngritjes dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Reforma në sistemin e drejtësisë është një nga reformat më të thella dhe gjithëpërfshirëse të ndërmarra në Shqipëri në vitet e fundit, e cila synon të adresojë problemin e hetimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, të evidentuara ndër pengesat kryesore për zhvillimin e metejshëm ekonomik shoqëror të vendit dhe për antarësimin në Bashkimin Evropian. Një nga komponentët kryesorë të kësaj reforme është ngritja e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI PROJEKTIN

Kohëzgjatja	Korrik 2019 – Prill 2020
Programi/ Fusha e zbatimit	Programi i Reformës në Drejtësi financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
Nevoja e zbatimit të këtij Projekti	Nevoja për informim mbi proceset e ndërmjetme ligjore dhe administrative, përcaktuese për ecurinë dhe finalizimin e krijimit të Gjykatave të Posaçme dhe SPAK si dhe nevoja më shumë komunikim dhe mbështetje në drejtimit të ngritjes së kapaciteteve administrative dhe njerëzore për fillimin e ushtrimit të kompetencave të Gjykatave të Posaçme dhe SPAK.
Qëllimi i Projektit	Qëllimi kryesor i projektit është monitorimi, vlerësimi dhe mbështetja në vazhdimësi e procesit të ngritjes dhe funksionimit të institucioneve kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ku përfshihen Gjykatat e Posaçme dhe SPAK.
Objektivat e Projektit	Objektivat specifikë të projektit janë: <ul style="list-style-type: none"> • Të monitorojë dhe vlerësojë procesin e ngritjes dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, përfshirë zbatimin e kompetencave të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në krijimin e Gjykatave të Posaçme dhe SPAK. • Të informojë dhe ndërgjegjësojë qytetarët dhe palët të interesuara mbi procesin e krijimit dhe funksionimit të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. • Të ndërveprojë me palët e interesuara nëpërmjet advokimit dhe mbështetjes së autoriteteve shtetërore përgjegjëse për zbatimin e reformës në drejtësi. • Të forcojë mbështetjen dhe besimin e publikut për institucionet e reja kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe të vendosë një standard të ri komunikimi dhe ndërveprimi me Gjykatat e Posaçme dhe SPAK.
Instrumentat dhe mekanizmat	Gjatë zbatimit të projektit dhe monitorimit, vlerësimit dhe mbështetjes së institucioneve kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, do të përdoret një kombinim i metodave, në përputhje me aktivitetet e parashikuara, të cilat do të jenë: (1) hulumtuese, (2) monitoruese (3) advokuese dhe (4) komunikuese.
Institucionet e reformës në drejtësi, fokusi i Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Gjykata e Shkallës së Parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar • Gjykata e Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar • SPAK një strukturë e cila përbëhet nga dy komponentë: <ul style="list-style-type: none"> • Prokuroria e Posaçme • Byroja Kombëtare e Hetimit
Produktet e Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Përgatitja e katër Buletineve Informuese, një në çdo tre muaj, nën titullin “SPAK Monitor” • Përgatitja e Broshurave Informative, në çdo dy-tre javë, nën titullin “SPAK Info” • Përgatitja e një Plani Komunikimi • Përgatitja dhe prezantimi i Web Project – SPAK • Hartimi i Strategjisë së Angazhimit të Palëve të Interesit (SAPI) • Përgatitja dhe shpërndarja e dy spoteve audiovizuale sensibilizuese e informuese • Zhvillimi i 3 Tryezave Tematike
Rezultatet e pritshme	Rezultatet e pritshme të projektit janë: <ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i saktë dhe gjithëpërfshirës i të gjitha hapave ligjore dhe administrativë për ngritjen e Gjykatave të Posaçme dhe SPAK. • Përmirësimi i informimit të qytetarëve, por edhe aktorëve të tjerë duke synuar të forcojë angazhimin e tyre dhe advokimin për çështje specifike të lidhura me ecurinë e ngritjes dhe funksionimit të Gjykatave të Posaçme dhe SPAK. • Vendosija e kontakteve ndërvepruese dhe hartimi i planeve të komunikimit me institucionet kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, me qëllim përmirësimin e komunikimit dhe pjesëmarrjes si edhe ofrimin e mbështetjes ndaj tyre.
Përfituesit kryesorë	Përfituesit kryesorë të projektit do të jenë: <ul style="list-style-type: none"> • Institucionet kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ku përfshihen Gjykatat e Posaçme dhe SPAK. • Në kuadër të komponentit të komunikimit, do të jenë përfitues gjithashtu edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organe kryesore për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të posaçëm. • Organizata, media, ekspertë, gazetarë, institucione shtetërore dhe ndërkombëtare si edhe qytetarët dhe publiku i gjerë do të përfitojnë në kuadër të projektit nëpërmjet një informimi më të mirë dhe gjithëpërfshirës të proceseve, pjesëmarrjes aktive në ndjekjen e zbatimit të hapave ligjorë për ngritjen e gjykatave të Posaçme dhe SPAK si edhe advokimit për të adresuar apo diskutuar çështje të rëndësishme të evidentuara gjatë zbatimit.